

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Për: "Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale"

Nr1 i prokurimit	632-25-7299-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale" me nr. të prokurimit 632-25-7299-2-1-1.

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"AROMA PLUS" SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ndue Perllushi LL-A3, Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

045 645 088

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mirvete Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Shpk.aroma@gmail.com

(Adresa elektronike)

13.05.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftimi për kontrate i datës 25.08.2025
2. Dosja e tenderit e datës 25.08.2025
3. Sqarimi i Dosjes se tenderit 03.12.2025
4. Hapja e tenderit 09.12.2025
5. Njoftimi për vendimin e AK – 23.04.2026
6. Kërkesa për rishqyrtim 28.04.2026
7. Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim 04.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifíkoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

09.12.2025

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifíkoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminim

Neni 27 Dosja e tenderit

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ANKESË

Operatori Ekonomik "AROMA PLUS" SH.P.K., në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, paraqet këtë ankesë pranë Organi Shqyrtues i Prokurimit kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale", me nr. 632-25-7299-2-1-1, si dhe kundër vendimit me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim.

Ankesa paraqitet për shkak se vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me gjendjen faktike, provat e administruara dhe dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së drejtë.

Pavarësisht argumenteve dhe provave të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar pretendimet tona pa një arsytim të plotë, objektiv dhe të bazuar në dispozitat ligjore, duke mos adresuar në substancë shkeljet e ngritura.

Vendimi i AK-së është formal dhe nuk përmban arsytim të mirëfilltë juridik. AK nuk ka trajtuar pretendimet në mënyrë individuale, por ka dhënë përgjigje të përgjithshme, duke mos përmbushur standardin minimal të arsyetimit. Kjo bie ndesh me parimet themelore të LPP-së dhe praktikën e OSHP-së, sipas së cilës çdo pretendim duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë dhe të argumentuar. Ju bashkangjesim Vendimin mbi Refuzimin e kërkeses për rishqyrtim:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "AROMA PLUS" SH.P.K., e dt.28.04.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale", Nr. i prokurimit- 632-23-7299-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-098-211, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 23.04.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:23.04.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Pretendimi nr 1

AK tek pretendimi nr. 1 tek mundesit tekniko dhe/ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2 per analizen financiare sipas AK nuk qendron sepse OE I rekomanduar per kontrate, ne te gjitha tabelat ka prezentuar çmimin + TVSH dhe Totali është prezentuar me TVSH. Ne Kerkesen per rishqyrtim ne si OE absolutikisht nuk kemi cekur se analizes financiare në tabelën e prezentuar i mungojnë te dhenat por ne në këtë kërkesë kemi trajtuar dy ceshtje. Ceshtjen e pushimeve vjetore si dhe ceshtjen e materialit. Pra, me pergjegjesi te plote materiale dhe morale e themi se AK manipulon per kete pretendim. Edhe njehere ne vazhdim po e cekim se pretendimi jonë në këtë analizë financiare se OE i rekomanduar për kontrate ka vepruar ne kundershtim me ligjin tek pushimet vjetore si dhe ka vepruar ne kundershtim me kerkese e AK-së per sasin e materialit. Shume shkurt po ua elaborojme edhe njehere ne kete ankesë dhe po e sqarojme pushimet vjetore si dhe sasin e materialit. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 1, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr 1

Operatori ekonomik CAPITAL X FET i rekomanduar për kontrate është në kundërshtim me ligjet e prokurimit. Kërkesa e AK-së tek pika 9.1 dhe 9.2 kërkesat mbi mundësit teknike dhe ose profesionale ka qenë (cit): *Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se punëtorëve se do ti paguan të gjithë punëtorët pagat e njëta me punëtorët e këtij sektori me BRUTO prej 400,00€ me të gjitha obligimet ku duhet të llogaritet pushimi vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës dhe ATK-së. Dhe dëshmia (cit): *Të dëshmojë me deklaratë origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe analizën financiare të detajuar (origjinale). Analizë financiare e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë analizën financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar, shpenzimet e materialit dhe të detyrimet tatimore.**

Kërkesë e AK-së ka qenë se cdo OE të paragesë një analizë financiare të detajuar ku pagat për punëtorë duhet të jenë 400 euro BRUTO me të gjitha obligimet ku duhen të llogariten pushimet vjetore sipas Ligjit të punës Nr. 03 L-212 si dhe ligjet e tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës dhe ATK-së. OE duhet të dorëzojë një analizë financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar shpenzimet e materialit dhe detyrimet tatimore. Mirëpo OE i rekomanduar për kontratë tek pushimet vjetore i ka llogaritur në kundërshtim me ligjin. Ai për një muaj ka llogaritur zëvendësimet e punëtorëve për vetëm 61.25 euro pa TVSH kur ti shtohet kësaj shume edhe TVSH-ja është e barabartë me 72.27 euro. Pastaj në analizë financiare është kërkuar edhe materiali higjienik. OE i rekomanduar për kontratë ka llogaritur material për 20 pozicione vetëm 67.60 euro pa TVSH, kur ti shtohet dhe TVSH-ja është e barabartë me 79.77 euro.

Po u'a prezantojmë analizën financiare sipas Ligjit me llogaritjet e duhura për 20 puntorë:

IV. Mesatarja e pushimeve vjetore per 20 punëtorë përfshirë

Sipas Ligjit te punes secilit puntore i takon pushimi vjetor prej katër jave që është rreth një muaji

Per ti zevendesuar keto pushime vjetore nevoiten: 1 puntore brenda 1(një) muaji humb 176 ore pune, te cilat duhet te zevendesohen, kurse për 20 puntore duhet të zëvendësohen $20 \cdot 176 = 3,520$ ore pune në vit.

Nr i puntoreve dhe stafi tjetër menaxhues A	Numri i oreve per nje (1) puntore C	Gjithsejt ore pune per 1 vit $D=(A \cdot C)$	Gjithsejt ore pune per 1 muaj $E=(D/12)$	Numri i puntoreve qe nevoitet per zevendesim $F=(E/176)$	
20	176	3,520	293.33	1.67	
Numëri i punëtorëve që duhet të zëvendësohen (a)	Paga mesatare bruto për punëtor (€) (b)	Shuma e pagave bruto (€) (c)	Kontributi i punëdh. për skemën e pensionit për një punëtor (€) (d)	Shuma e kontributeve të punëdhënësit (€) (e)	Gjithsejtë pagat me të gjitha taksat e aplikuara në Kosovë (€) (f)
1.67	400.00	666.67	20.68	34.47	701.13 €
Gjithshtë pushimet vjetore per 20 punëtor per nje muaj					701.13 €

Pra, sipas Ligjit per 20 punëtorë për pushime vjetore nevoiten per zëvendësimin e tyre nevoiten 1.67. Pra, 1.67 punëtorë paga mesatare 400 euro Bruto që është e barabartë $400 \cdot 1.67 = 666.67$ + kontributi i punëdhënësit është 20.68 e që është e barabartë $1.67 \cdot 20.68 = 34.47$ e kur të mbledhen te gjitha këto shuma atëherë na jep totalin për zëvendësimet e puntoreve 701.13 euro pa TVSH. Kur ti shtohet edhe 18% TVSH-ja eshte e barabarte me 827.33 euro. Ndersa, OE I rekomanduar per kontrate per tere vitin sipas analizes se tii financiare ka kalkuluar 735.00 euro per nje vite e qe kjo është në kundërshtim me Ligjin nr. 03 L-212. Provë analiza financiare e OE CAPITAL X FET:

NR.	EMERTIMET Zevendësimet e Puntoreve ne rast të Pushimeve Vjetore	Nr punëtorve për zëvendësim per muaj	Shuma e Pagave Bruto	Trusti pensional	Totali per 1 Vit
1	Punëtorët e Pastrimit	1.75	400.00	20.00	735.00

Pretendimi nr. 2

Përgjigja e AK-së ndaj pretendimit tonë nr. 2 është e paqartë, jo substanciale dhe nuk adreson fare thelbin e pretendimit ankimor.

AK është mjaftuar vetëm me konstatimin se OE i rekomanduar për kontratë, sipas formulës për çmim jo normalisht të ulët, nuk rezulton me çmim jo normalisht të ulët. Një arsyetim i tillë nuk qëndron, pasi pretendimi ynë nuk ka qenë vetëm lidhur me formulën matematikore, por me pamundësinë reale të realizimit të kontratës në përputhje me Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Ne kemi paraqitur analizë konkrete financiare dhe kemi dëshmuar me çmime reale të tregut se vetëm dy pozicione të kërkuara në FDT tejkalojnë shumën prej 215.33 euro në muaj, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë për të gjitha **20 pozicionet** ka ofertuar vetëm 67.60 euro pa TVSH, respektivisht 79.77 euro me TVSH.

AK në përgjigjen e saj nuk ka kundërshtuar asnjë nga kalkulimet tona, nuk ka ofruar asnjë analizë financiare dhe nuk ka sqaruar se si me këtë vlerë mund të përmbushen kërkesat obligative të dosjes së tenderit.

Prandaj, konsiderojmë se AK ka dështuar të shqyrtojë në mënyrë objektive realizueshmërinë e ofertës dhe OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohej si ofertë e papërgjegjshme dhe në kundërshtim me Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 2, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Materiali Higjenik

Pozicioni	Materiali	Sasia	Cmimi	Totali
1	Detergjent per dysheme 1L	121	€ 0.90	€ 108.90
2	Dezifektues per banjo 1L	115	€ 1.20	€ 138.00
3	Pastues per lavaman dhe guaca 1L	55	€ 0.92	€ 50.60
4	Sprej pastres per tavolina 1L	41	€ 0.79	€ 32.39
5	Sapun I lengshem per duar 1L	91	€ 0.89	€ 80.99
6	Doreza gome 1 përdorimesh /pako (10 copë ne pako)	44	€ 2.70	€ 118.80
7	Qese për mbeturina 150 L/ pako (10 copë ne pako)	62	€ 1.10	€ 68.20
8	Qese për mbeturina 35 L /pako (10 copë ne pako)	69	€ 0.55	€ 37.95
9	Letër për duar rolne(me aparatn përcjellës)	322	€ 1.30	€ 418.60
10	Letër Tualeti /Komplet (10 copë në Komplet)	119	€ 1.00	€ 119.00
11	Trolex (50*30)cm	45	€ 0.90	€ 40.50
12	Lecka për pastrimin e monitorit te PC	41	€ 0.80	€ 32.80
13	Kove dhe xhoker nga 2 copë për secilin punëtor (zëvendësohen me te reja çdo 3 muaj)	44	€ 6.50	€ 95.33
14	Lëkur për xhama	36	€ 0.50	€ 18.00
15	Fshesa Elektrike për çdo kat, si dhe objektet e tjera në kuadër të komunës	18	€ 80.00	€ 120.00
16	Fshesa me lopata për çdo kat, si dhe objektet e tjera në kuadër të komunës	33	€ 2.50	€ 82.50
17	Fshesa për Merimanga	28	€ 1.80	€ 50.40
18	Sapun dezinfektues / Deodorant për guace	65	€ 1.40	€ 91.00
19	Sprej për xhama /750 ml	56	€ 0.79	€ 44.24
20	Brusha për guace	50	€ 1.30	€ 65.00
TOTALI				€ 1,813.20

1. Tek pozicioni nr.13 për Kova dhe Xhokera me 2 copë për secilin punëtorë që duhen të zëvendësohen gido 3 muaj 44 copë * 6.50 euro (cmimi standart) = 286.00 euro, por pasi qe AK ka paraparë qe keto kova te ndërrohen njëherë në 3 muaj brenda vitit qe i bie të ndërrohen 4 herë atëherë: $286*4 = 1144 / 12 = 95.33$ euro ne muaj.
2. Tek pozicioni nr.15 për Fshisa elektrike për gido kat si dhe objektet e tjera në kuadër të Komunës 18 copë * 80.00 euro (cmimi standart) = 1440 / 12 = 120.00 euro në muaj.

Pra, në bazë të kësaj qe e elabuaruam me larte konstatoime se OE I rekomanduar per kontrat per pastrimin e ketvrc siperfaqeve ka parapare vetem 79.77 euro Bruto. Nga kjo konstatoime se AK ne menyre te kunderligjshme e ka shpallur fitues kete OE dhe ne kundershtim ne kriteret e DT si dhe me specifikimet teknike te detvrueshme. Sa per informate po e nioftojme AK se ylera e parashikuar per kete kontrat ka qen 180,000.00 keshtu qe buxheti ka qenë i miaftueshëm. Atëherë Komisioni i vleresimit menjëherë është duhur ta eliminoi këtë oferte si të pa përgjegjshme dhe cmimi jo normalisht te ulët. Pra, sa per informate 79.77 euro material nie familie me 5 anetare ne nie banese rreth 60 metra katror i shpenzon, ndërsa këtu duhet te pastrohen sipas FDT 13,538 metra katror. OE i rekomandur për kontratë ka llogaritur material për 20 pozicione vetëm 67.60 euro pa TVSH, kur ti shtohet dhe TVSH-ja është e barabartë me 79.77 euro. Provë analiza financiare e OE i rekomanduar per kontrate CAPITAL X FET:

**Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale
me prokurimi 632-25-7299-2-1-1**

Nr.	EMËRTIMET	NR. I TE PUNËSUARVE	Pagesa Bruto	Shuma e Pagave Bruto 400*21	Kontributit I Punëdhësnit për pension 400*5%	Shuma e kontributeve e punëdhësnit 20*21	Gjithsej Pagat me të Gjitha Taksat 1 Muaj 8400+420	Gjithsej Pagat me të Gjitha Taksat 12 Muaj 8820*12	
1	Punëtorët e Pastrimit & Menaxheri	21	400.00	8,400.00	20.00	420.00	8,820.00	105,840.00	
2	*(20 punëtor pastrimi=1 menaxher)						Totale	8,820.00	105,840.00

Nr.	EMËRTIMET Zëvendësimet e Puntoreve ne rast të Pushimeve Vjetore	Nr punëtorve për zëvendësim per muaj	Shuma e Pagave Bruto	Trusti pensional	Totale për 1 Vit
1	Punëtorët e Pastrimit	1.75	400.00	20.00	735.00

Nr.	Emërtimi	Totale për 1 Muaj	Totale 12 Muaj
1	Materiali Higjienik	67.60	811.17

Totali Ofertes 1 Muaj		
Nr.	Emërtimet	
1	Pagat	8,820.00
2	Zëvendësimet	61.25
3	Materiali Higjienik	67.60
4	Totali Ofertes pa TVSH	8,948.85
5	TVSH	1,610.79
6	Totali Ofertes me TVSH	10,559.64

Totali Ofertes 24 Muaj		
Nr.	Emërtimet	
1	Pagat	105,840.00
2	Zëvendësimet	735.00
3	Materiali Higjienik	811.17
4	Totali Ofertes pa TVSH	107,386.17
5	TVSH	19,329.51
6	Totali Ofertes me TVSH	126,715.68



Pretendimi nr. 3

Sa i përket pretendimit nr. 3, përgjigja e AK-së është e paplotë, jo substanciale dhe në kundërshtim me obligimin për shqyrtim të plotë të pretendimeve ankimore.

AK nuk ka trajtuar fare pretendimet tona konkrete ndaj GOE I "INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.P.K & "Pro Tech Clean " por është mjaftuar vetëm me konstatimin se nuk do të lëshohet në shqyrtimin e tyre me arsyetimin se i njëjti grup operatorësh është shpallur i pasuksesshëm.

Një arsyetim i tillë nuk qëndron, pasi në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi paraqitur shkelje konkrete ligjore dhe materiale, respektivisht se ky OE ka paraqitur kalkulime në kundërshtim me kërkesat ligjore lidhur me pushimet vjetore, si dhe ka ofertuar çmime të parealizueshme për materialet e kërkuara sipas FDT-së.

AK nuk ka shqyrtuar asnjë nga këto pretendime, nuk ka dhënë asnjë arsyetim faktik apo ligjor dhe nuk ka kundërshtuar asnjë nga provat e paraqitura nga ana jonë.

Prandaj, konsiderojmë se AK ka dështuar të bëjë shqyrtim të plotë dhe objektiv të pretendimit tonë, duke dhënë një përgjigje formale dhe jo meritore ndaj çështjeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim.

Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 3, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr.3

Edhe Grupi i Operatoreve Ekonomik "INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.P.K & "Pro Tech Clean" SH.P.K I cili tenderi i tyre ka qene i pasukseshem nga Komisioni i Autoritetit Kontraktues. Tek zevendsimet e punetoreve nuk i ka llogaritur pushimet vjetore konformë Ligiit e Punës. Sipas analizës financiare të këtij GOE pushimet vjetore i ka llogaritur 715.15 euro BRUTO, ndërsa sipas Ligiit është dashur ti llogarisë për 20 puntorë për pushime vjetore nevojiten për zëvendesimin e tyre 1.67. Pra, 1.67 puntorë paga mesatare 400 euro Bruto që është e barabartë $400 * 1.67 = 666.67$ + kontributi i punëdhënësit është 20.68 e që është e barabartë $1.67 * 20.68 = 34.47$ e kur të mbledhen te gjitha këto shuma atëherë na jep totalin për zëvendesimet e puntoreve 701.13 euro pa TVSH. Kur ti shtohet edhe 18% TVSH-ja është e barabarte me 827.33 euro.

Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin nr. 4, AK edhe në këtë rast ka dështuar të japë përgjigje konkrete, të arsyetuar dhe të bazuar në faktet e paraqitura në kërkesën tonë për rishqyrtim.

Ne kemi argumentuar qartë se edhe GOE INTERNACIONAL GROUP BASE dhe Pro Tech Clean, njëjtë sikurse OE i rekomanduar për kontratë, në analizën financiare të paraqitur ka ofertuar sasi dhe vlera të materialeve që janë në kundërshtim të plotë me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të përcaktuara nga vetë AK në dosjen e tenderit.

Nga analiza financiare rezulton se ky GOE ka llogaritur vlerën mujore të materialit në shumën prej vetëm 67.87 euro, vlerë kjo që është ekonomikisht e perealizueshme dhe në disproporcion të plotë me kërkesat e FDT-së për furnizimin me materiale në 20 pozicione obligative për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

AK në përgjigjen e saj nuk ka kundërshtuar asnjë nga kalkulimet tona, nuk ka bërë asnjë analizë financiare, nuk ka dhënë asnjë arsyetim profesional dhe nuk ka sqaruar se si me këtë vlerë mund të përmbushen kërkesat teknike të dosjes së tenderit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se AK nuk ka bërë vlerësim objektiv dhe material të ofertës së këtij GOE, ndërsa e njëjta është dashur të vlerësohej si ofertë e papërgjegjshme, e perealizueshme dhe në kundërshtim me Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 4, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr.4

Edhe ky GOE ashtu siq edhe Operatori i parë tek materiali ka llogaritur 67.87 euro material higjenik per pastrim me TVSH. Pra, pasi e elaburuam me larte po konstatojme se nuk ka nevojte te perseriten edhe niehere gjerat. Prove analiza financiare e INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K:

ANALIZA FINANCIARE IGB SHPK		
I	llogaritjet	I
	Pagat e punetoreve me 12.12.2014. tabelat e aplikacionit me 2014.0000	
Nr	Pershkrimi i hapave per llogaritjen e pages per nje punetor	VLERAT
1	PAGA BRUTO	€ 400.00
2	Kontributi i punedhensesit	€ 20.00
3	Kontributi i punemarresit	€ 20.00
4	Paga qe tathet	€ 380.00
5	Te ardhurat e tatueshme	€ 10.40
6	Paga neto per punetor	€ 369.60
7	Paga bruto + Kontributi i punedhensesit	€ 420.00
8	Paga bruto + Kontributi i punedhensesit per 20 punetore	€ 8,400.00
9	Pagat e 20 punetoreve + TVSH 18%	€ 9,912.00
II	Materiali Higjenik Mujoz +TVSH 18%	€ 67.87
III	Zevendesimi i punetoreve per muaj	
1	Paga bruto per nje punetor	€ 400.00
2	Numri i oreve mujore te punes 176 ore apo 22 dite	176.00
3	Numri i oreve te maksimal te pushimit sipas ligjit te punes 160ore ose 20 dite	€ 160.00
4	Shperndarja e zevendesimeve per muaj 12 muaj	€ 12.00
5	Kalkulimi konforme ligjit te punes - Paga bruto /176 Ore mujore pune * 160 Ore mujore pushimi /12 muaj te shperndare OSE paga bruto / 22 dite pune *20 dite pushimi /12 muaj te shperndare	€ 30.30
4	Zevendesimi per punetor MUJORE per 20 punetore + TVSH 18%	€ 715.15
	Gjithsejte Oferta :	
I	Totali mujor	€ 10,695.02
II	Totali vjetor	€ 128,340.24



Pretendimi nr.5

Sa i perket pretendimit nr. 5, AK edhe ne kete rast nuk ka bere shqyrtim meritor te pretendimeve tona, por eshte mjaftuar me nje pergjigje formale duke deklaruar se nuk do te leskohet ne shqyrtimin e ofertës së GOE Krasniqi SH.P.K dhe Allton SH.P.K, me arsyetimin se i njejti eshte shpallur si i pasuksesshem. Nje arsyetim i tille nuk qendron dhe nuk e liron AK nga obligimi ligjor per te trajtuar dhe arsyetuar secilin pretendim ankimor te paraqitur nga OE.

Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi argumentuar me prova konkrete se edhe ky GOE, në analizën financiare të paraqitur, tek pozicionet e materialit ka ofertuar shumë prej vetëm **986.11 euro**, vlerë kjo që nuk është në përputhje me sasinë, llojin dhe kërkesat obligative të përcaktuara në Specifikimet Teknike të Detyrueshme të dosjes së tenderit.

AK nuk ka trajtuar asnjë nga kalkulimet dhe provat tona, nuk ka dhënë asnjë analizë financiare apo arsyetim profesional lidhur me realizueshmërinë e kësaj oferte dhe nuk ka kundërshtuar asnjë nga faktet e paraqitura nga ana jonë.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se edhe në këtë pretendim AK ka dështuar të bëjë shqyrtim të plotë, objektiv dhe të arsyetuar të pretendimeve tona, duke dhënë një përgjigje formale dhe jo meritore, në kundërshtim me parimet e trajtimit të drejtë dhe vlerësimit objektiv të ofertave. Të bashkangjitur gjeni pretendimin tone nr. 5, të Kërkesës për Rishqyrtim:

Pretendimi nr. 5

Edhe GOE Krasniqi SH.P.K & Allton SH.P.K i cili tenderi i tyre ka gene i pasukseshem nga Komisioni i Autoritetit Kontraktues. Tek pozicioni i materialit ka dhënë cmin jo normalisht të ulët në krahasim me specifikat e DT. Ky GOE ka paraparë për pastrimin e ketvje siperfaqeve 986.11 euro gjë që nuk është ekuivalent me sasinë e materialit e cila është kerkuar. Provë analiza financiare e GOE Krasniqi SH.P.K & Allton SH.P.K:



Krasniqi SH.P.K - Analiza financiare e ofertës

I. Paga bruto, neto dhe kontributet për një punëtor:

Punëtori	Paga bruto (a)	Kontributi i punëdhënësit për skemën e pensionit (b)	Kontributi i punëdhënësit për skemën e pensionit (c)	Të ardhurat e tatueshme (d)	Tatimi i mbajtur në burim (e)	Paga e paguara pas tatimit- Neto (f)
1	400.00	20.00	20.00	380.00	10.40	369.60 €
		$b=a*5\%$	$c=a*5\%$	$d=a-c$	$e=(d*80)*4\%$	$f=a-c-e$

II. Pagat me të gjitha kontributet e aplikueshme në Kosovë:

Numëri i punësorëve (a)	Pagesa bruto (b)	Shuma e pagave bruto (c)	Kontributi i punëdh. për skemën e pensionit për një punëtor (d)	Shuma e kontributëve të punëdhënësit (e)	Gjithëjtë pagat me të gjitha taksat e aplikuarat në Kosovë (f)
20	400.00	8,000.00	20.00	400.00	8,400.00 € punëtor
		$c=a*b$		$e=a*d$	$f=c+e$

III. Uniformat:

Përshkrimi	Njësia	Sasia 6 muajore	Cmimi (b)	Shuma (c)	Për 6 muaj 2 parë rroba	Totali për 12 muaj (e)
Uniforma	parë	20	8	160	2	320.00 €
Gjithsejfte uniformat						320.00 €

Shuma mujore për uniforma është 8.89 €

IV. Mesatarja e pushimeve vjetore për 20 punëtorë përfshirë

Sipas Ligjit të punës secilit punëtor i takon pushimi vjetor prej katër javë që lëvizë rreth një muaji

Për të zëvendësuar këto pushime vjetore nevojiten: 1 punëtor brenda 1(një) muaji humb: 176 ore pune, të cilat duhet të zëvendësohen, kurse për 20 punëtorë duhet të zëvendësohen $20*176 = 3,520$ ore pune në vit.

Nr i punësorëve dhe stafi qeter menaxhues A	Numri i orëve për një (1) punëtor C	Gjithëjtë ore pune për 1 vit $D=(A*C)$	Gjithëjtë ore pune për 1 muaj $E=(D/12)$	Numri i punësorëve që nevojiten për zëvendësim $F=(E/176)$
20	176	3,520	293.33	1.67

Numëri i punësorëve që duhet të zëvendësohen (a)	Pagesa mesatare bruto për punëtor(€) (b)	Shuma e pagave bruto (€) (c)	Kontributi i punëdh. për skemën e pensionit për një punëtor (€) (d)	Shuma e kontributëve të punëdhënësit (€) (e)	Gjithëjtë pagat me të gjitha taksat e aplikuarat në Kosovë (€) (f)
1.67	400.00	666.67	20.68	34.47	701.13 €
Gjithëjtë pushimet vjetore për 20 punëtor për një muaj					701.13 €

V. Materiali higjienik € 986.11

II	€	8,400.00
III	€	8.89
IV	€	701.13
V	€	986.11
Shuma (II+III+IV+V)		10,096.13
TVSH		1,817.30
Totali me TVSH		11,913.44
Gjithëjtë vlera e ofertësTotali për 12 muaj		142,961.23 €



Pretendimi nr. 6

AK në këtë rast nuk ka trajtuar fare përmbajtjen e pretendimit tonë ankimor, por është kufizuar vetëm në faktin se GOE **Erik SH.P.K** dhe **Schafberger Jr. GmbH** është eliminuar për shkak të mosvazhdimin të validitetit të ofertës.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e lartcekura, kerkojme qe të merret ky:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : “**AROMA PLUS**” SH.P.K. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: “*Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale*” me nr. të prokurimit 632-25-7299-2-1-1

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e aktivitetit te prokurimit Autoriteti Kontraktues per aktivitetin:me titull: “*Mirëmbajtja higjienike e objekteve komunale*” me nr. të prokurimit 632-25-7299-2-1-1 dhe lenda te kthehet ne rivlersim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbje financiare nga shpenzimet e pergaditjes se ofertes dhe kerkeses per rishqyrtim dhe ankesave ne OSHP, Humbje kohe dhe angazhimi i panevojshem i burimeve njerezore dhe profesionale.

[REDACTED]

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

